

CHARACTERISTICS OF VISUALIZATION IN LITERACY: MEANING AND IMPORTANCE

KARAKTERISTIKAT E VIZUELIZIMIT NË SHKRIM-LEXIMIN

FILLESTAR: KUPTIMI DHE RËNDËSIA

Arbresha ZENKI-DALIPI¹

¹*Department of Teacher Education, Faculty of Pedagogy, University of Tetova*

^{*}*Corresponding author e-mail: arbresha.zenki@unite.edu.mk*

Abstrakti

Tendenca për t'iu përgjigjur sa më shumë kërkesave të vazhdueshme dhe të ndryshueshme në arsim, ka bërë që nocioni i vizualizimit të haset çdo ditë e më shumë në teorinë dhe praktikën pedagogjike, kuptime që theksojnë aplikimin e të njëjtës si strategji në të kuptuarit dhe vlerësimin. Një imazh, përkatësisht zotërimi i vizualizimit mund të ofrojë kuptim të thellë, të bëjë që një ide ose proces të ketë papritmas kuptim dhe të çojë në rrugën drejt kuptimit përfundimtar të një pjese të komplikuar të shkencës. Informacioni në libra paraqitet kryesisht si verbal, njohuri që nxënësit i riprodhojnë si shënime ose figura. Shndërrimi i kuptimit të këtyre kodeve në njohuri ndodh për shkak të aftësisë për të lidhur lidhjet referenciale midis sistemeve verbale dhe vizuale. Vlerat e objekteve jogjuhësore pasqyrojnë kryesisht lehtësinë e përcaktimit të fjalëve dhe theksimin e marrëdhënies hierarkike në modelet e rrjetit të shoqërimit dhe kuptimit. Punimi, përpara se të elaboron shkallën e vënies së vizuelizimit në procesin e shkrim-leximit fillestar, do të bëjë përshkrimin e aspekteve kyçe të vizualizimit. Kuptimi dhe rëndësia e kësaj strategjie do të qartësohen dhe konkretizohen përmes shembujve nga praktika pedagogjike. Përpos theksit i cili do të vihet në procesin e leximit, do të theksohet edhe mundësia e vlerësimit të të kuptuarit e të lexuar përmes strategjisë së vizuelizimit.

Fjalë kyçe: *Shkrim-leximi fillestar, strategji, vizuelizimi*

Abstract:

The tendency to respond as much as possible to the continuous and changing demands in education has made the notion of visualization to be encountered every day more and more in pedagogical theory and practice, meanings that emphasize the application of the same as a strategy in its understanding and appreciation. An image, or mastery of visualization, can provide deep understanding, make an idea or process suddenly make sense, and lead the way to the ultimate understanding of a complicated piece of science. Information in books is mainly presented as verbal, knowledge that students reproduce as notes or pictures. The transformation of the meaning of these codes into knowledge occurs due to the ability to connect referential links between the verbal and visual systems. The values of non-linguistic objects mainly reflect the ease of defining words and the emphasis on hierarchical relationships in network models of association and meaning. The paper, before elaborating the degree of visualization in the initial literacy process, will describe the key aspects of visualization. The meaning and importance of this strategy will be clarified and concretized through examples from pedagogical practice. In addition to the emphasis that will be placed on the reading process, the possibility of evaluating reading comprehension through the visualization strategy will also be emphasized.

Keywords: Literacy, strategy, visualization.

1. Hyrje

Ekziston shprehje shumë e vjetër që thotë se një fotografi vlen sa një mijë fjalë. Kur flasim për kuptimin, kjo shprehje mund të parafrazohet, "shfaqja vizuale i ndihmon lexuesit të kuptojnë, organizojnë dhe mbajnë mend disa nga këto fjalë" (Duke & Pearson, 2002, fq.51). Shprehja në fjalë nxjerr në pah rëndësinë e vizualizimit në procesin e të kuptuarit të thellë. Ka evidencë se teknikat e vizualizimit janë përdorur që nga shekulli i dytë para Krishtit në formën e hartave dhe vizatimeve. Ato ekzistuese mbulojnë një gamë të gjerë fushash aplikimi me një numër artistësh që i përdorin si mënyrë të fuqishme e madje shprehje artistike (Zenki-Dalipi, 2018).

"Një imazh mund të ofrojë kuptim të thellë, të nxisë ndonjë ide ose proces që papritmas të krijojë kuptim dhe të udhëheqë në rrugë drejt kuptimit përfundimtar të një pjese të komplikuar të shkencës" (Tanton, J., 2016, fq.7). Duke pasur parasysh faktin se nxënësit bombardohen çdo ditë e më shumë nga shkenca dhe teknologjia dinamike me imazhe nga video lojërat dhe shumë më tepër nga teknologjia moderne, ekziston rreziku i pranimit të leximit si një aktivitet shumë pasiv. Për këtë arsye, vizualizimi mund të transformojë qëndrimin e nxënësve të të gjitha moshave nga lexuesit pasivë në aktivë. "Ajshtajni shpesh ndau se i gjithë mendimi i tij ishte vizual, e ai më vonë ka luftuar për t'i kthyer idetë e tij vizuale në fjalë dhe simbole (West,2014). Nëpërmjet vizualizimit, mundësohet prezantimi që lejon krijimin e ideve konkrete dhe abstrakte rreth asaj që lexohet, krijim të lidhjeve me tekstin dhe sigurisht më të rëndësishmen, rritjen e nivelit të të kuptuarit.

Strategjia e lartëpërmendur e ndihmon lexuesin të përfshihet në leximin e tij dhe ta bëjë atë të paharrueshëm. Në procesin e përshtatjes së imazheve mendore, ata vazhdojnë të lexojnë dhe e bëjnë leximin një lexim tredimensional. Prezantimi vizual e ndihmon lexuesin të shqyrtojë idetë konkrete dhe abstrakte të leximit. "Vizualizimi ofron një metodë për të parë të padukshmen" (McCormick, DeFanti, & Brown, 1987, fq.3). Kjo strategji njohëse mundëson një takim imagjinar me botën abstrakte.

Sipas autorëve Keene dhe Zimmerman, lexuesit e shakthtë krijojnë në mënyrë spontane dhe qëllimisht imazhe mendore gjatë dhe pas leximit. Imazhet lindin nga pesë shqisat dhe emocionet dhe mbështeten në njohuritë e mëparshme të lexuesit (2007). Vizualizimi është strategji që jo vetëm mbështet shkrim-leximin, por gjithashtu kontribuon në inkurajimin e të menduarit kritik, d.m.th. të menduarit krijues, e mendjet kreative krijojnë. Për krijim të imazheve mendore nevojitet "teknologji mendore", përkatësisht "teknologji kognitive si çdo mjet që ndihmon për të kapërcyer kufizimin e mendjes ... në të menduarit, të mësuarit dhe aktivitetet e zgjidhjes së problemeve"(Pea, 1987). Strategjia në fjalë mundëson tejkalimin e kufizimit të të pamurit të njeriut dhe të kuptuarit për të qartësuar dhe mprehur "të shikuarit".

Zimmerman dhe Cunningham vizualizimin e konsiderojnë si "aftësi, procesi dhe produkti i krijimit, interpretimit, përdorimit dhe të menduarit rreth fotografive, imazheve, diagrameve në mendjen tonë, në letër ose nëpërmjet mjeteve teknologjike, me qëllim shfaqjen dhe përcjelljen e informacionit, të menduarit rreth të njëjtës, zhvillimin e ideve të panjohura më parë dhe avancimin e të kuptuarit" (1991, fq.3). Ky përkufizim gjithëpërfshirës shpjegon krijimin e imazheve mendore si një mundësi për të kapërcyer kufizimet njerëzore, domethënë për të zhvilluar aftësi të mprehur për të kuptuarit e koncepteve në vend që thjesht të "shihni" imazhin.

Paraqitja grafike si strategji që mbështet vizualizimin u mundëson nxënësve të paraqesin drejtpërdrejt të menduarit dhe të kuptuarit e tyre përmes organizatorëve grafikë dhe ata janë: organizuesi hierarkik, organizuesi krahasues, organizuesi vijues, diagrami i Venit, hartat semantike, "Merimanga", harta të të mendurit, organizator kauzal, harta e personazheve, harta e sekuencave etj.

2. Vizualizimi. Pse dhe si vizualizojmë?

Janë të shumtë ata që e pranojnë dhe e përkufizojnë vizualizimin si praktikë në jetën reale.

Vizualizimi është kapaciteti i lindur që shfaqet që nga lojërat tona të para imagjinative. Të gjithë i kujtojmë momentet kur fluturimi ishte i mundur, biseda me kafshët ishte shumë interesante dhe argëtuese dhe kur shkopi i zakonshëm shndërrohej në një shkop magjik. Të jetuarit në një "botë reale" të tillë na mundësoi të vizualizojmë që nga fëmijëria.

Arsyeja që ne vizualizojmë është se me një paraqitje të tillë vizuele kemi sukses në përmirësimin e paraqitjes mendore në mënyrë që të përmirësojmë dhe të heqim të gjitha reflektimet imagjinare. Vizualizimi mundëson të kuptuarit e vetë problemit dhe komponentëve përbërës të problemit. Në rast se analizojmë qëllimet e vizualizimit dhe zgjidhjes së problemeve do të vërejmë se janë identike. Përfaqësimi fillestar (hyrja në problem) është qëllimi që identifikohet dhe ndihmon në njohjen kur edhe nxit impulse për të menduar për të. Modelimi dhe planifikimi si qëllime ofrojnë kushte për kuptimin e thellë të problemit dhe stimulojnë vazhdimësinë. Këto vibrime të marra gjatë këtij procesi mendor krijojnë supozime dhe rrethana për një version më të thjeshtë dhe kuptim të thellë. Funkzioni kontrollues i vizualizimit mund të tregojë një kuptim të marrëdhënies shkakësore të elementeve të një problemi, identifikim me një problem tjetër dhe ofron lidhje me zgjidhjet nga përvojat e mëparshme.

Sipas Piggot dhe Woodham për vizualizimin theksojnë se u takojnë aftësitë që mbështesin proceset të cilat shtrihen përtej përdorimit të figurave dhe diagrameve për të ndihmuar zgjidhësin e problemit me një situatë problemi. Vizualizimi është në zemër të zgjidhjes së vetë problemit. Autorët e njëjtë theksojnë se ka më shumë për të vizualizuar sesa mund të duket në sy (2009).

Për proceset e vizualizimit që kalojnë nxënësit gjatë zgjidhjes së një problemi, Ho Siew Yin i rendit ato si më poshtë:

Kuptimi i marrëdhënive hapësinore të elementeve të problemit;

Lidhja me një problem të zgjidhur më parë;

Ndërtimi i një paraqitjeje vizuale (në mendje, në letër, ose nëpërmjet përdorimit të mjeteve ose teknologjisë);

Përdorimi i paraqitjes vizuale për të zgjidhur problemin;

Kodimi i përgjigjes së problemit (2018).

Përvoja vizuale mundëson aftësinë për të generalizuar situatë përmes mbledhjes së tipareve të theksuara të brendshme të komponentëve përbërës të problemit, ndërsa lidhja mundëson mbështetje në strukturën ose lidhjen përmes kujtesës së ndonjë problemi të mëparshëm (Zenki-Dalipi, 2018). Për të mos u kufizuar vetëm në kuadrin e të menduarit të ngurtë dhe për të kaluar drejt zgjidhjeve më të mira dhe ideve të reja, ky proces përsëritës hapëron drejt identifikimit dhe krahasimit me përvojën tjetër. Si komponentë, identifikimi dhe krahasimi lejojnë gjetjen e përvojës personale me përvojën e përbashkët dhe krahasimin e dy ose më shumë përfaqësimeve. Kur një sërë përpjekjesh janë të pasuksesshme në zgjidhjen e një problemi, është shumë e rëndësishme të mbahet në mend pika fillestare që ndihmon "kthim" në gjendjen fillestare.

2. Çfarë paraqet shkrim-leximi fillestar në raport me vizuelizimin?

“Gjuha e dukshme” apo mbresat pamore nga bota e qytetëruar ndikuan në ekspresivitetin e komunikimit pamor dhe lëvizjen e edukimit në drejtim të pajisjes së nxënësve me vetëdije estetike. Shkrim-leximi vizual mbështetet në idenë se imazhet lexohen dhe se simbolet, shenjat dhe format përcjellin kuptimin që duhet të praktikohet për t'u interpretuar në tekst të shkruar ose të shtypur. Aftësia për shkrim-lexim është shkathhtësi transformuese e cila ka ndikim në të menduarit tonë, në mënyrën se si mendojmë, veprojmë dhe si bashkëveprojmë me të tjerët.

Tendenca për t'u përgjigjur sa më shumë kërkesave të vazhdueshme dhe të ndryshueshme në arsim ka bërë që ky nocion të gjendet që në teorinë klasike dhe mesjetare në literaturën pedagogjike. Nuk është vetëm shkencë pedagogjike ajo që është përpjekur të definojë, domethënë të përdorë shkrim-leximin pamor. Ky nocion gjendet në historinë e artit, dizajnit, artit të filmit, arkitekturës, shkencave kompjuterike e të tjera, duke deklaruar se ky lloj shkrim-leximi nënkupton aftësinë për të perceptuar dhe prosecuar, interpretuar atë që shihet, kurse shfaqja vizuale që krijohet duke përfshirë dhe shqisat e tjera, i lejon njerëzit të mësojnë prej tij.

2. Rëndësia e vizuelizimit

Nxënësit fitojnë një kuptim më të thellë të një koncepti të lexuar kur ata inkurajohen dhe lejohen të krijojnë një përfaqësim jogjuhësor të atij koncepti. Shkrim-leximi pamor bën të mundur rritjen e aftësisë për të menduar për atë që është mësuar. Në procesin e përshtatjes së imazheve mendore, nxënësit vazhdojnë të lexojnë duke e bërë leximin tredimensional. Prezantimi vizual e ndihmon lexuesin të eksplorojë leximin në kërkim të ideve konkrete dhe abstrakte. Ata krijojnë në mënyrë spontane dhe qëllimisht imazhe mendore, të cilat lindin nga shqisat dhe emocionet dhe mbështeten në njohuritë e mëparshme të lexuesit.

Sipas Brawn, përfitimet e nxënësve nga integrimi i imazheve përfshijnë: të menduarit kompleks, krijues dhe zgjidhjen e problemeve, aftësitë shprehëse verbale dhe joverbale, të mësuarit e aplikuar në kontekste të reja, rritjen e aftësive bashkëpunuese, rritjen e vetëbesimit dhe motivimit (2007, fq.173). Përfitimet e bashkangjitura jo vetëm që ndikojnë në përmirësimin e procesit mësimor, ato lehtësojnë dhe ndihmojnë në kapërcimin e situatave jetësore. Ato i drejtojnë nxënësit të vëzhgojnë botën përreth tyre me një perceptim estetik të fokusuar dhe të rritur.

Vizualizimi në procesin e shkrim-leximit përfshin aftësinë për të *dekoduar, interpretuar, krijuar, parashtruar pyetje, dhe vlerësuar* tekste të cilat në vend të fjalëve komunikojnë me imazhe vizuale. Aftësia për të "parë" me mendje atë që shihet me sy përfaqëson një element të praktikës mësimore që është një sfidë për mësuesit të cilët duhet të inkorporojnë mënyra për të manipuluar dhe komunikuar informacione, përkatësisht ti vendosin nxënësit në aktivitete dhe situata për të aftësuar të kuptojnë si tekstet vizuale përcjellin kuptim.

Imazhi ose "filmi në mendjet tona" ("movie in our minds") na angazhon dhe sipas Bridge, Long dhe Vinograd, rrit efektivitetin e kujtesës sonë (1989, fq.370). Për të plotësuar këtë qëndrim Gambrell dhe Javitz theksojnë se "imazhimi mendor ndihmon proceset e tjera të cilat përdoren në të kuptuarit e leximit, si nxjerrja e konkluzioneve, bërja e parashikimeve dhe përdorimi i skemave" (1993, fq.267).

Në përvojat e hershme të shkrim-leximit, mësuesit synojnë që nxënësit të mësojnë një mori aftësish shkrim-leximi. Parashikimi, bërja e pyetjeve, krijimi i lidhjeve, nxjerrja e përfundimeve dhe përmbledhja janë veprime që ndodhin natyrshëm dhe pa vetëdije të lexuesit strategjikë. Megjithatë të rëndësishme dhe vendosin bazat për të kuptuarit e leximit, këto strategji dhe aftësi nuk sigurojnë kuptim të plotë. Kjo arrihet kur nxënësit kuptojnë dhe kujtojnë atë që lexojnë. Për të kuptuar, rëndësia e mjetit dhe strategjisë së pamohueshme të shkrim-leximit, vizualizimi, është e pashmangshme.

Autorët e njëjtë nënvizojnë se aftësia e krijimit të imazheve mendore të asaj që lexojnë, ndikon në aftësinë e të kuptuarit e asaj që lexohet dhe të mbajturit mend (Gambrell & Javitz 1993. Vizualizimi mund të përdoret gjithashtu si një mjet për të kontrolluar të kuptuarit e leximit. Mund të zbatohet nëse nxënësit i kërkohej të vizatojnë një figurë nga ajo që ka lexuar ose të tregojnë një aspekt të mbajtur mend të tekstit. Nuk ka dyshim se nxënësit do ta pranojnë me kënaqësi këtë formë të vlerësimit të leximit.

Përfundim

Ky punim përpos elaborimit të vizualizimit si strategji, kishte për qëllim ndërgjegjësimin për nivelin dhe përparësitë e aplikimit të vizualizimit si strategji në procesin e shkrim-leximit. Mbështetur në referenca të autorëve të huaj, mund të themi se edhe pse nuk është term i panjohur, vizualizimi si strategji duket se është jashtë interesave të autorëve të nënqiellit tonë dhe atij në regjion. Për të qartësuar arsyen se pse vizualizojmë dhe rëndësinë e asaj në shkrim-lexim fillestar, nxjerrëm në pah se nocioni në fjalë është shumë i rëndësishëm dhe gjendet në historinë e artit, dizajnit, artit të filmit, arkitekturës, shkencave kompjuterike e të tjera. Përpjekja modeste për të drejtuar vëmendjen në të kuptuarit e nivelit dhe avantazhet e aplikimit të vizualizimit si strategji në procesin e të lexuarit, të kuptuarit e të lexuarit dhe të shkruarit, shpresojmë se do të motivojë autorët drejt studimeve nga fusha e shkrim-leximit fillestar me theks në ndikimin e strategjisë së vizualizimit.

References

- [1]. Bridge, C., Long, S., & Winograd, P. (1989). *The effects of reader and text characteristics on imagery reported during and after reading*. Reading Research Quarterly. 24(3)
- [2]. Brown, S. (2007). An arts-integrated approach for elementary-level students. *Childhood Education*, 83
- [3]. Duke, K., & Pearson, D.,(2002), *Effective Practices for Developing Reading Comprehension, What Research Has To Say About Reading Instruction*, 4th ed. Newark DE: International Reading Association
- [4]. Gambrell L.B., & Jawitz, P.B. (1993). Mental imagery, text illustrations, and children's story comprehension and recall. *Reading Research Quarterly*, 28(3)
- [5]. Keene and Zimmerman,(2007), *Mosaic of Thought: The Power of Comprehension Strategy Instruction*, 2nd Edition, Portsmouth, NH:Heinemann
- [6]. McCormick, H., DeFanti, A. & Brown D. (1987), Visualization in scientific computing: Definition, domain, and recommendations. *Computer Graphics*,21,3-13
- [7]. Pea, R. (1987), Cognitive technologies for mathematics education. In Schoenfeld, A. H. (Ed.)*Cognitive science and mathematics education*, Hillsdale, NJ: Erlbaum
- [8]. Piggott, J., Woodham,L. (2009), Thinking Through, and By, Visualizing, <https://nrich.maths.org/6447>
- [9]. Tanton, J. (2016), *The Power of Mathematical Visualization*, Virginia:The Great Courses
- [10]. West, Th. (2014),*Thinking like Einstein: Returning to our visual roots with the emerging revolution in computer information visualization*, New York: Prometheus Books
- [11]. Zenki-Dalipi, A,(2018), Улогата на визуелизација во поучување на математика, *Зборник на трудови*, Арс Ламина, Скопје
- [12]. Zimmermann W.,& Cunningham S. (1991), Editor's introduction: What is mathematical visualization. In W.Zimmermann, & S. Cunningham (Eds.), *Visualization in teaching and learning mathematics*, Washington, DC: Mathematical Association of America.